



INNOVET ALBANIA BULETIN

Le të kontribuojmë për fuqizimin e komunitetit të AFP-së!

albanianskills
We promote skills



Të dashur lexues,

Kam nderin e jashtëzakonshëm t'ju prezantoj me publikimin e tretë të buletinit INNOVET ALBANIA. Unë jam Alma Shkreli dhe prej 14 vitesh punoj si eksperte këshillimi e arsimit dhe aftësimit profesional për një sërë projektsh të ndryshme. E nisa përfshirjen time në Albanian Skills në vitin 2015, menjëherë pas edicionit të parë të konkurseve të aftësive. Pasi pashë dhe preka nga afër në këtë edicion të parë, energjinë e grumbulluar, kreativitetin, inovacionin dhe mendësinë e të rinjve shqiptarë të përfshirë për të marrë përsipër risqe, vendosa të investoj edhe vetë për të bërë më shumë sesa thjesht punën time të paguar. Kam punuar kryesisht si koordinatorë për vullnetarët, së bashku me nismëtarët e Albanian Skills duke krijuar hapa, procedura dhe struktura për rekrutimin dhe menaxhimin e vullnetarëve. Në të vërtetë, disa herë ka qenë një punë mjaft sfiduese, por në të njëjtën kohë një mundësi për të bërë gjërat e duhura për të rinjtë tanë në Shqipëri.

Çështja që nënvizohet në këtë buletin është inovacioni në Arsimin dhe Trajnimin Profesional, por jo vetëm, në jetën e përditshme dhe në biznes gjithashtu. Do të keni kënaqësinë të lexoni rreth të rinjve krijues dhe të guximshëm që shfrytëzuan rastin gjatë këtij viti sfidues i cili na ka dhënë të gjithëve një mësim të vlefshëm për të qenë gjithmonë krijues, inovativë dhe të guximshëm.

Nga përvoja jonë e përbashkët e vitit të kaluar dhe gjithashtu nga përvoja ime me Albanian Skills, mesazhi im për lexuesit e këtij buletini dhe për të gjithë të rinjtë është se duhet të shohim mundësi në çdo sfidë dhe të gjithë ne duhet të jemi në gjendje të rindërtojmë veten dhe jetën tonë përgjatë gjithë kohës.

Qëndroni inovativ!

Alma Shkreli,

Anëtare e Bordit Ekzekutiv të Albanian Skills - National Association for Skills Competitions

Rubrikat e Innovet Albania - Publikimi i Tretë

Ky publikim u përgatit dhe u editua nga: Orjeta Ramaj & Fatma Memalli

Arsimi dhe Formimi Profesional nga këndvështrimi i studentëve të AFP

Disa fjalë nga Alion Emini dhe Daniel Doçi, nxënës të Shkollës Teknike Elektrike "Gjergj Canco", Tiranë.

Rrugëtimi i House Kitchen - Konkursi që bëri bashkë aktorët më të rëndësishëm të AFP.

Në Maj të vitit 2020 u realizua Konkursi "House Kitchen". Ishte një nismë e re, një ide që pati vështirësi fillimisht...Këtu, shprehja "Kurrë mos thuaj kurrë", morri një kuptim të veçantë.

"Intervistë me nxënësin Jusuf Rrustaj mbi rrobotin e tij Spac.

Roboti Anticovid që lufton çdo mëngjes "të keqen" në Shkollën "Gjergj Canco".

Nisma më e re nga Albanian Skills! Fokus grupe me protagonistë vetë nxënësit.

Fokus grupi i parë i këtij lloji u organizua në fund të janarit të shkruar nën tematikën "Inovacioni në AFP sipas nxënësve të shkollave profesionale në Shqipëri".

Një vit nga pandemia Covid-19. Një event për të reflektuar mbi gjurmët e lëna në biznes, edukim dhe përditshmëri

Prej më shumë se një viti, kriza e pandemisë COVID-19 është ulur kryeneçe këmbëkryq në realitetin botëror..

INTERVET WB - Hapat e radhës

Short News - Coffee Talk

Në takimin e Janarit, u diskutua për fuqizimin e marrëdhënies midis Shkollave të AFP-së dhe bizneseve!

NISMA MË E RE NGA ALBANIAN SKILLS! FOKUS GRUPE ME PROTAGONISTË VETË NXËNËSIT!



Është besimi ynë i fortë se statusi i studentit nuk mund të shihet më thjesht si një "marrës" pasiv dhe përfitues në zinxhirin e përgjithshëm të sistemit arsimor. Ata janë shpesh disa hapa përpara në këto ndryshime transformuese të botës për shkak të digjitalizimit të të gjithë jetës, dhe për këtë arsye ata duhet të shihen si të barbartë në prfshirjen aktive në sistemin arsimor ashtu si kontribuesit e tjerë kryesorë, dhe për më tepër të konsiderohen si "qendra" e sistemi i edukimit. Me synimin e krijimit të një rrjeti të qëndrueshëm komunikimi dhe bashkëpunimi midis studentëve dhe të rinjve në sistemin e arsimit dhe formimit profesional, Albanian Skills ka ndërmarrë iniciativën e organizimit të një serie fokus grupesh, ku vetë studentët do të marrin rolin e protagonistëve për të shkëmbyer në mënyrë konstruktive me njëri-tjetrin ide, mendime, qëndrime, shqetësime dhe informacione.

Fokus grupi i parë i këtij lloji u organizua në fund të Janarit nën tematikën "Inovacioni në AFP në këndvështrimin e studentëve të shkollave profesionale në Shqipëri". Harta e pjesëmarrjes së studentëve u përhap në disa shkolla në vend duke përfshirë një numër studentësh nga Shkolla Elektrike-Teknike "Gjergj Canco" në Tiranë, studentë të tjerë nga Shkolla e Mesme Industriale "Ali Myftiu" në Elbasan dhe nga Shkolla e Mesme Ekonomike Teknike "Isuf" Gjata në Korçë. Studentë të sfondeve dhe profileve të ndryshëm, u bashkuan virtualisht për të vlerësuar përvojat e tyre dhe për të diskutuar më në detaje rreth inovacionit, mësimdhënies, mundësive të praktikës, programeve mësimore, infrastrukturës dhe mjedisit shoqëror në ambientin e shkollës ku ata studiojnë. Në fund të këtij fokus grupi të parë, vetë pjesëmarrësit e vlerësuan shumë një aktivitet të tillë që u mundësoi të shprehin mendimet e tyre lirshëm dhe pa ndonjë "frikë".

Arsimi dhe aftësimi profesional ka një histori të gjatë në vendin tonë, të shënuar nga kapituj uljesh dhe ngritjesh. Për të adresuar një sërë çështjesh të ndryshme që prekin komunitetin e AFP-së, me protagonistë vetë studentët, qëndroni të akorduar për fokus grupet e ardhshme!

ARSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL NGA KËNDVËSHTRIMI I STUDENTËVE TË AFP-SË

Disa fjalë nga Alion Emini, nxënës i Shkollës Teknike Elektrike "Gjergj Canco", Tiranë,

Arsimi profesional është çelësi për një karrierë të suksesshme në të ardhmen!

Herët apo vonë të gjithëve na duhet të zgjedhim një profesion apo zana të caktuar në përshtatje me aftësitë dhe pritshmëritë tona. Disa mund ta pëlqejnë dhe e kanë pasion atë ç'ka bëjnë ndërsa të tjerë jo. Por, a e dini që sot të gjithë të rinjtë kanë mundësinë të zgjedhin që në adoleshencë se çfarë profesioni duan të kenë për të ardhmen e tyre? Sipas një përkufizimi, arsimi profesional është arsimi që përgatit njerëzit (konkretisht të rinjtë) për të punuar në profesione të caktuara, si p.sh. në tregti, zejtari, teknikë, apo në profesione të tilla si inxhinieri, kontabilitet, infermieri, mjekësi, arkitekturë, teknologji e shumë të tjera.



Personalisht kam zgjedhur që të vazhdoj arsimin profesional dhe të studioj në degën Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, profili IT Support në shkollën Teknike Elektrike 'Gjergj Canco'. Që në klasë të tetë të shkollës 9-vjeçare vura re që kisha goxha interes në fushën e TIK-ut. Më intrigoi shumë kompjuterat dhe merrja shpesh iniciativën t'i studioja vetë. Shikoja shumë video në YouTube se çfarë bënin të tjerët në këtë punë dhe fillova të mendoja se në të ardhmen do të doja të studioja për IT.

Më poshtë dua të ndaj disa momente nga praktikat që shkolla ime kryen nëpër kompani të shumta.



Ndërkohë, arsimi profesional ka fituar shumë popullaritet vitet e fundit. Duke parë që pas shkollës së mesme secili prej nesh ka një profesion, më shumë se kurrë, të rinjtë janë duke zgjedhur arsimin profesional për shkak të shumë avantazheve:

1. Profesion pas shkollës së mesme (arsyeja kryesore);
2. Praktike nëpër laboratorët që ofron shkolla;
3. Praktike nëpër biznese dhe kompani prestigjioze;
4. Zhvillim të aftësive profesionale dhe jetësore.

Si frekuentues i shkollës së mesme profesionale, do t'i rekomandoja të rinjve që janë në dilemë për të vazhduar ose jo shkollën profesionale, BËJENI ! Arsimi profesional është çelësi për një karrierë të suksesshme në të ardhmen! Për sa i përket të ardhmes time jam i sigurt që pasi të përfundoj arsimin profesional do të kem mundësinë të punësohem nëpër biznese apo kompani të shumta, si edhe të kryej edhe studimet e larta. Dëshiroj dhe aspiroj që në të ardhmen të jem një programues i zoti, me një interes të veçantë në fushën Gaming, dhe pse jo një Game Developer i suksesshëm!

Disa fjalë nga Daniel Doçi, nxënës i Shkollës Teknike Elektrike "Gjergj Canco", Tiranë.

Janë mbushur thuhet 3 vite që kur mora vendimin për t'u bërë pjesë e arsimit profesional dhe dua të them se është një vendim për të cilin nuk jam penduar. Arsimi profesional në Shqipëri ka avancuar shumë përgjatë këtyre viteve. Në fillim ishte si një shkollim normal, thjesht me disa lëndë shtesë dhe një vit ekstra, por me kalimin e viteve janë bërë shumë përmirësime në mënyrë që të sigurohet e ardhmja e një studenti.



Bashkëpunimet me biznesin janë bërë shumë më të shpeshta dhe konkurset nuk mungojnë. Cilësia e skelet-kurrikulës është rregulluar shumë, por ka akoma vend për përmirësim. Integrimi i teknologjisë dhe inovacionit në shkolla po ecën me hapa të shpejtë duke bërë që shkollat të pajisen me mjete të reja, duke bërë që mësimdhënia të jetë sa më e plotësuar, por ka vend gjithashtu edhe për përmirësime të mëtejshme. Që një student të zgjedhë me bindje arsimin profesional, atij duhet t'i shtrohen qartazi disa pika që tregojnë se arsimi profesional është një zgjedhje shumë e mirë e që ja vlen. Për më tepër, për nxënësit e arsimit profesional është më e vështirë të arrihet shkolla e lartë e dëshiruar, krahasuar me nxënësit e arsimit të përgjithshëm. Këto janë disa nga gjërat kryesore që unë mendoj se duhet të përmirësohen.

Në tërësi arsimi profesional është një opsion solid që siguron të ardhmen tënde!

HAPAT E ARDHSHEM TË INTERVET WB PËR 2021

Shpresojmë që INTERVET WB të vazhdojë aktivitetin e tij me takime fizike, shkëmbime, ekipe tematike, job shadowing dhe shkollë verore gjatë vitit 2021. Pavarësisht vështirësive që kanë lindur nga situata aktuale pandemike, secili nga drejtuesit e projektit dhe partnerët e zbatimit po bëjnë çmos për të siguruar vazhdimësinë e projektit si dhe ndikimin e tij pozitiv në vendet përkatëse të Ballkanit Perëndimor. Aktivitetet e parashikuara të Intervet WB për 2021 janë si më poshtë:



INTERVET WB 2021	
01	Raundi i parë i mobilitetit per studentet - Qershor 2021 ne Forli, Itali
02	Mbledhja e dyte Transnacionale - Qershor 2021 ne Sarajeve
03	Raundi i 2 i Thematic Teams - Dordrecht (21 Maj - 4 Qershor)
04	Raundi i 1 i Job Shadowing - Dordrecht (21 Maj - 4 Qershor)
05	Raundi i 2 i Shkolles Verore Korrik 2021 ne Seville, Spanje
06	Thirrja e 2te per mobilitetin e studenteve - Maj; Mobiliteti - Shtator
07	Thirrja e 2te per Job Shadowing - Prill; Mobiliteti - Tetor, Lion

- Takimi i Dytë Transnacional - Qershor 2021 në Sarajevë
- Raundi i parë i mobiliteteve për nxënësit - Qershor 2021 në Forli, Itali
- Thirrja e dytë për mobilitetet e nxënësve do të jetë e hapur në Maj, ndërkohë që shkëmbimi do të zhvillohet në Shtator
- Raundi 2 i Skuadrave Tematike - Dordrecht (21 Maj - 4 Qershor)
- Raundi 1 i Shadowing Job - Dordrecht (21 Maj - 4 Qershor)
- Thirrja për raundin e dytë të Job Shadowing do të jetë e hapur në Prill, ndërkohë ajo do të mbahet në Tetor në Lyon
- Raundi 2 i Shkollës Verore - Korrik 2021 në Seville

RRUGËTIMI I HOUSE KITCHEN - KONKURSI RISI QË EDHE PSE NË DISTANCË, BËRI BASHKË AKTORËT MË TË RËNDËSISHËM TË AFP-SË!

Praktikat profesionale zënë një vend të veçantë në formimin profesional të nxënësve të shkollës sonë. Është një përvojë e hershme, e cila i pajis nxënësit me dije praktike në mësimnxënien e realizimin e kompetencave lëndore dhe ato të ashtuquajtura kompetenca "soft". Por periudha e vështirë e mbylljes nga rreziku i pandemisë Covid-19 na nxiti drejt mënyrave të tjera inovative e të papraktikuara më parë, të cilat duheshin përshtatur me një sërë vështirësish si: konsultimi, realizimi i detyrave, performanca profesionale dhe bashkëveprimi në distancë. Mjetet digjitale dhe aftësitë profesionale ishin dy pikat kyçe. Shkolla Tregtare e ka në traditë realizimin e konkurseve midis nxënësve. Pikerisht këtë vit, kur nxënësit nuk mund të ishin në shkollë fizikisht, na lindi ideja të realizonim konkurset nga shtëpitë e secilit nxënës, ashtu siç realizonim edhe mësimin online.



Në Maj të vitit 2020 nisi të realizohej Konkursi "House Kitchen". Ishte një nismë e re, një ide që pati vështirësi fillimisht, pasi vetë nxënësit ndiheshin në mëdyshje. Këtu, shprehja "Kurrë mos thuaj kurrë", mori një kuptim të veçantë. Duhej një përkushtim jo i zakonit nga gjithë aktorët pjesëmarrës. Madje u lidhëm edhe me një televizion lokal, për të prezantuar konkursin e nxënësve. Çdo mësues kujdestar dhe instruktorët e kuzhinës udhëzonin online nxënësit e perzgjedhur si përfaqësues të klasave të 11-ta. Që një bashkënim i ngushtë dhe i jashtëzakonshëm në kohë pandemie mes vetë mësuesve, nxënësve, përfaqësuesve të biznesit dhe medias. Morrën pjesë 10 nxënës që garuan miqësisht ndërmjet tyre, për më shumë se 1 muaj. Ishte mbreslënëse kur nisi konkursi dhe nxënësit kishin emocione të vërteta sepse ishin në transmetim direkt, në një "emision" të moderuar nga Deni Llanaj, ndërsa ne si mësues bashkë me nxënësit mundoheshim t'i inkurajonim.

Ata u bënë protagonistë për disa javë rresht, derisa konkursit i erdhi momenti final, i cili u realizua në shkollë nën masa të rrepta anti-Covid. Ishin 4 finalistët, të cilët dy nga dy, realizuan punimet e tyre në kuzhinën moderne të shkolles tonë. Fituesja e vendit të parë ishte nxënësjja Rozelja Kuka dhe trofeu i marrë nga ky konkurs i mundësoi asaj një kontrat pune tek Resort "Mandarina".



Duhet theksuar ndihma dhe përkushtimi i biznesit me përfaqësi të Z. Aldo Mehmeti, mjeshtri i talentuar i kulinariisë, i cili vlerësonte dhe inkurajonte nxënësit gjatë gjithë performancës së tyre si edhe motivimi dhe ndihma e madhe që dhanë vetë prindërit dhe familjarët e nxënësve. Kur duam të realizojmë diçka ndryshe, mjafton dëshira, pasioni dhe përkushtimi e pastaj gjenden mjetet dhe mundësitë për të arritur ç'ka synojmë. Kështu ndodhi dhe me ne. Një eksperiencë që do të ngelet gjatë në memorien tonë...

SPAC - ROBOTI ANTICOID QË LUFTON ÇDO MËNGJES "TË KEQEN" NË SHKOLLËN "GJERGJ CANCO".

Intervistë me nxënësin Jusuf Rustaj



Përshëndetje Jusuf! Ta nisim me një prezantim të shkurtër të vetes?

Përshëndetje! Unë quhem Jusuf Rustaj, jam 17 vjeç dhe aktualisht studioj TIK, në shkollën e mesme profesionale 'Gjergj Canco' në Tiranë.

Si nisi dhe si u zhvillua pasioni jot për teknologjinë?


Që në vegjëli, më ka tërhequr shumë bota e Informatikës dhe e Teknologjisë. Pajisjet që luaja, i çmontoja për t'i studiuar çfarë ka nën ato plastika të lodrave tona dhe se si funksiononin qarqet, ingranazhet e mekanizmat e tyre. Duke u rritur mësova ta zgjeroj njohurinë e mia përmes burimeve të ndryshme. Në moshën 10 vjeçare laptopi im i parë, ishte mësuesi im që më ndihmoi të eksploroja fushën e Software-it dhe atë të Hardware-it.

Si vendose të studioje në arsimin profesional?

Pasi mbarova arsimin 9-vjeçar, isha në një dilemë shumë të madhe se çfarë shkolle të vazhdoja. Dëshiroja shumë të mësoja në një shkollë ku kishte seriozitet, përkushtim dhe shumë praktika mësimore, por siç dihet cilësia ka edhe koston e saj, dhe unë ëndërroja një shkollë private pasi mendoja se do të më ofroheshin alternativa më të mira, por mundësitë ekonomike nuk ma premtinin diçka të tillë. Duke hulumtuar bashkë me prindërit e mi, gjetëm shkollën profesionale "GJERGJ CANCO" në Tiranë.

Që nga viti i parë kam filluar të mësoj bazat e robotikës dhe programimit. Kam ndërtuar disa mini projekte robotike, duke eksperimentuar me to dhe duke ua treguar mesueseve të shkolles. Kështu me kalimin e kohës fillova të mesoj shumë e më shumë në fushën e robotikës. Duke u menduar për ide të ndryshme se si mund të krijojmë mjete teknologjike që e ndihmojnë shoqërinë për zgjidhjen e problemeve të përditëshme, fillova të ndërtoj robotë të thjeshtë, por që kryejnë funksionin e tyre dhe janë totalisht të përdorëshëm. Një ndër ata robotë është roboti im, që e kam quajtur: "SPAC".

Tani besojmë se ka ardhur momenti të na flasësh për SPAK-un, robotin e famshëm ANTI-COVID?



Mund të flas për SPAK-un me shumë dëshirë! Dhe jo, nuk është ai SPAK-u që mendoni ju!! Smart Protection Anti Covid është një robot i cili kryen funksionin e SPAK-ut dhe lufton të keqen, por duke u marrë me elementin e një niveli mikrobiologjik: "KORONAVIRUSIN".


- SPAK-u, është një robot i dizenuar për të dezinfektuar ambjentet e mëdha duke lëvizur në mënyrë autonome.
- Ai është i pajisur me një sistem sprucimi i cili merr dezinfektantin nga depozita dhe e nxjerr atë në mënyrë të sprucuar nga krahët e tij.
- Krahët janë të dizenuar që të lëvizin me një kënd nga 0 deri në 180 gradë, duke filluar nga poshtë - lart, në mënyrë që të mbulohet një sipërfaqe e gjerë dezinfektimi.
- Ai ka disa sensorë të pozicionuar tek: sytë e tij, trupi, të loklizuar majtas, djathtas dhe mbrapa tij.
- Roboti funksionon me bateri të rikarikueshme, që i mundësojnë atij kohë të mjaftueshme për të kryer të gjithë dezinfektimin e ambjentit.
- Pika kyçe e këtij roboti është software-i. Një software i ndërtuar me algoritme të ndryshme të cilat e bëjnë robotin të jetë sa më autonom.

Autonom do të thotë që paisja të jetë e aftë të lëvizë pa e komanduar një person, por duke u komanduar nga një software. Që nga momenti i parë që roboti ndizet në një ambient të ri, ai fillon skanimin e territorit ku do të lëvizë. Ky proces bëhet vetëm njëherë në fillim, në mënyrë të atillë që roboti të krijojë një hartë virtuale me ambjentin e skanuar, duke e ruajtur atë në kujtesën e tij. Pasi skanimi ka përfunduar, roboti tashmë e di, se ku ndodhet në bazë të hartës virtuale që ka krijuar dhe sensorëve që ai ka. Këta sensorë janë të aftë të masin distancën nga muri në mur. Më pas i takon algoritmit të robotit të kryej llogaritjet dhe të bëjë të mundur që roboti të lëvizë në mes të korridorit. Në këtë mënyrë ai nxjerr dezinfektantin nga krahët e tij dhe bën të mundur mbulimin e pjesës më të madhe të ambjentit me dezinfektant. Ky është qëllimi se perse e ndërtova këtë robot. Te ndizet automatikisht në orën 6 të mëngjesit dhe të fillojë dezinfektimin e të gjithë shkollës!

I gjithë procesi zgjat vetëm një orë, duke marrë parasysh këtu që shkolla jonë ka 4 kate, ku roboti duhet të shkojë në çdo klasë. Në orën 7 roboti tashmë ka përfunduar dezinfektimin dhe kthehet në vendin e tij. SPAC-u është një robot i sponsorizuar nga shkolla, dhe unë i jam shumë mirënjohës të gjithë atyre që më mbështetën. Një falenderim nga zemra shkon për të gjithë mësuesit e mi që më kanë ndihmuar kur kam patur nevojë. Dhe në veçanti një falenderim i madh, për drejtoreshën tonë Znj. HEDIJE GJONI, që duke parë dëshirën time për ti zhvilluar më tej njohuritë e mia, më lejoi të përdor laboratorin 3D që shkolla ka e më ofroi mbështetje. Deri në projektin tim të rradhës ju uroj çdo të mirë dhe mirupafshim!

NJË VIT NGA PNDEMIA E COVID-19. NJË EVENT PËR TË REFLEKTUAR MBI GJURMËT E LËNA NË BIZNES, EDUKIM DHE PËRDITSHMËRI.

Shkruar nga Ekipi i Albanian Skills



Ky event na risolli edhe njëherë në vëmendje faktin që impakti i kësaj pandemie reflekton mbi të gjitha domosdoshmërinë dhe nevojën e vazhdueshme njerëzore për ndryshim, përditësim dhe inovacion, në mënyrë që të tejkalohen dhe parandalohen kriza të ngjashme.

Prej më shumë së një viti, kriza e pandemisë COVID-19 është ulur kryeneçe këmbëkryq në realitetin botëror, duke nxjerrë në pah e thelluar në njërin anë problematikat shumëplanëshe ekzistuese, dhe në anën tjetër e ka vënë njerëzimin përballë sfidave të reja. Në një farë forme, rrjedha normale e përditshmërive tona është ndryshuar rrënjësisht, e ndërkohë prej sektorëve më të prekur janë sigurisht fusha e edukimit dhe bota e biznesit. Për të trajtuar impaktin e kësaj pandemie në të treja këto dimensione, Albanian Skills organizoi eventin më aktual me temë "Impakti i Covid-19 në biznes, edukim dhe jetën e përditshme". Të fituarat paneliste ishin Viola Shahini, Asistent-pedagoge në Itali dhe kandidate për Phd, Amarilda Canameti, specialiste bankare ACA në NatWest Group dhe Ingrid Kau, Konsultuese SAP SD nga Crystal System.

Viola solli në diskutim përvojën e sistemit të edukimit në Itali përgjatë pandemisë dhe ecurinë e mësimdhënies online. Ajo preku problematikat dhe vështirësitë e hasura për zhvillimin e këtij procesi në distancë. Më tej, vijoi Amarilda, e cila u ndal më specifiku në impaktin e pandemisë në botën e biznesit, duke sjellë një panoramë të dyanshme të bizneseve që kanë lulëzuar dhe bizneseve që janë përballur me një krizë të thellë mbijetese. Ndër të tjera, Amarilda e vendosi theksin gjithashtu edhe tek aftësitë e së ardhmes. Inteligjenca Artificiale, Teknologjia e Informacionit, Analiza e të dhënave dhe profesionet që kanë në fokus qëndrueshmërinë klimatike, pasi këto të fundit premtajn shumë për të ardhmen! Eventu u përmbyll me Ingridin, e cila duke qenë e punësuar në fushën e IT dhe programimit, ndau eksperiencën e saj personale lidhur me impaktin në këtë sektor.

LAJM I SHKURTËR - KAFEJA E PASDITES

Coffee Talk ose Kafeja e Pasdites, është krijuar si një traditë e përmuajshme që synon të forcojë më tej komunitetin e AFP-së në Shqipëri. Tematikat e këtij eventi janë të ndryshme çdo muaj dhe evidentojnë si problematikat ashtu edhe qasjet inovative apo rastet që duhet të jenë frymëzim për zhvillimin e arsimit profesional në Shqipëri dhe jo vetëm por edhe për punësimin e të rinjve që përfundojnë këtë arsim. Në takimin e Shkurtit, u diskutua mbi bashkëpunimin midis institucioneve të AFP-së, shkëmbimin e ideve dhe përvojave, në mënyrë që të jemi më të përgatitur dhe më efikas në punën e përditshme me AFP-në. Znj. Julita Bimbli, drejtoresha e Shkollës Profesionale "Fan. S. Noli" në Korçë, dhe në të njëjtën kohë një kontribuese e fortë në Coffee Talk Events, ndau me pjesëmarrësit përvojën e tyre në bashkëpunimin me shkollat dhe institucionet e AFP-së, dhe si ndikon kjo më pas në punën e tyre me studentët, projektet dhe proceset e të nxënies. Rasti i tyre ishte i vlefshëm për të gjitha shkollat e tjera që morën pjesë, disa prej të cilave shprehën dëshirën për të shkëmbyer kontakte dhe informacione, për të zhvilluar më tej bashkëpunimin midis Komunitetit të AFP-së. Për më tepër ishte një përvojë e shkëlqyer për studentët dhe prindërit e AFP-së, si dhe mbështetësit e arsimit profesional, të dinin më shumë rreth projekteve të përbashkëta midis shkollave, shkëmbimin e përvojave midis institucioneve të AFP-së në Shqipëri, etj, kështu që ju ftojmë të na ndiqni në rrjetet tona sociale dhe të bëheni pjesë e takimeve tona mujore!

Na ndiqni në rrjetet tona sociale - AlbanianSkills

Website: www.albanianskills.org

Media Sociale: AlbanianSkills

E-mail: albanianskills@gmail.com